



QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

KRAHASIM I VEPRAVE PENALE DHE DËNIMEVE RESPEKTIVE NË FUSHËN TATIMORE NË SHQIPËRI DHE DISA SHTETE TË BE

Tabela e Përmbajtjes

1. Veprat penale sipas ligjit të procedurave tatimore.....	3
Rasti i Shqipërisë.....	9
Vepra penale të tjera sipas Kodit Penal:	12
2. Material krahasues për veprat penale dhe dënimet- raste të shteteve të BE	15
Rasti i Austrisë	15
Rasti i Francës	17
Rasti i Gjermanisë	18
Rasti i Greqisë	19
Rasti i Hollandës	21
Rasti i Italisë.....	23
Rasti i Mbretërisë së Bashkuar.....	25

1. Veprat penale sipas ligjit të procedurave tatimore.

Duke qenë se, të ardhurat nga tatimet përbëjnë zërat kryesorë të buxhetit të shtetit, mbledhja dhe administrimi i tyre përbën një ndër sfidat më të rëndësishme të strukturave përkatëse që operojnë në këtë drejtim. Goditja e korrupsionit, e evazionit fiskal dhe e informalitetit në përgjithësi në këtë fushë janë ndër detyrat parësore të administratës tatimore.

Përgjegjësinë për fillimin e hetimit penal ndaj subjektit tatimpagues, dhe vënien në dispozicion ndaj prokurorisë të të gjithë informacionit të nevojshëm për zhvillimin e hetimit penal, e kanë strukturat e ngarkuara me identifikimin dhe raportimin e shkeljeve të parashikuara në ligjin e procedurave tatimore. Për të gjitha shkeljet e parashikuara në ligjin e procedurave tatimore kur ato përbëjnë vepër penale administrata tatimore ka detyrimin ligjor që të fillojë një hetim penal dhe më pas ta referojë atë në prokurori. Nga sa kuptohet dhe më sipër duhet që në të gjitha rrethanat e mësipërme, jo vetëm të vërtetohen elementet materiale të konsumimit të veprës penale, por njëkohësisht duhet të vërtetohet që, nga ana subjektive të kenë ekzistuar elementet e dashjes për të nxjerrë përfitim material.

Në praktikë shpesh është e vështirë për këto struktura, që të evidentojnë aftësinë paguese të subjektit për pagimin e detyrimit. Për këtë nevojitet një bashkëpunim ndërinstitutional.

Një moment i rëndësishëm është konstatimi i fajit në këto vepra. Pra të vërtetohet paraprakisht qëllimi i posaçëm i autorit, i cili devijon nga pagimi i detyrimit tatimor. Sa më sipër, të gjitha këto rrethana e çojnë një tatimpagues drejt konsumimit të një veprë penale.

Kriter kryesor i ndarjes në disa lloje të veprave penale, sipas doktrinės së të drejtës penale, është:

- natyra e veprës,
- ndërtimi strukturor,
- objekti,
- forma e fajësisë dhe shkalla e rrezikshmërisë.

Mbi këto kritere është mbështetur ligjvënësi në ndarjen në katër vepra penale të vendosura në seksionin VI, të kreut III të kodit Penal “Veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve”.

Po ashtu edhe legjislacioni tatimor ka në fokus veprat e ndryshme penale që lidhen në këtë fushë, duke përcaktuar edhe sanksionet rast pas rasti, apo vepër pas veprë.

Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 i Procedurave Tatimore i ndryshuar parashikon veprat penale në fushën fiskale në nenin 131.

Neni 131:

1. Personi, i cili, për çdo tatim të vendosur nga një ligj tatimor, kryen ndonjërin nga veprat që vijojnë, **dënohet në përputhje me Kodin Penal kur:**

- a) me dashje përpiket të kryejë evazion tatimor;

- a/1) kryen evazion tatimor siç parashikohet në pikën 2, të nenit 116, të këtij ligji, me dashje nuk mbledh tatimin ose nuk e paguan atë në buxhet
- b) me dashje nuk mbledh detyrimin tatimor dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ose nuk i paguan ato në buxhet.
- c) me dashje fsheh ose shkatërron libra dhe regjistrime, dokumente, deklarata apo informacion tjetër të rëndësishëm për detyrimin tatimor;
- ç) me dashje dorëzon dokumente, deklarata tatimore ose informacion të falsifikuar;
- d) me dashje nuk i bindet një kërkesë me shkrim për t'u paraqitur në organet tatimore;
- dh) me dashje ndërhyr në vlerësimin ose mbledhjen e tatimit;
- e) kërcënon ose kryen shkelje ndaj një zyrtari tatimor;
- ë) në bashkëpunim me një zyrtar tatimor, paguan ose pranon ryshfete;
- e) i ofron ryshfet një zyrtari tatimor;
- g) me dashje jep informacion tatimor në mënyrë të paautorizuar me ligj ose rregullore.

Pika 2 e nenit 116 (referuar pikës 1, a.1 të këtij neni) përfshin dhe:

- Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pages.
- Mbajtja në ruajtje, përdorimi ose transporti i mallrave të pashoqëruara me dokumente tatimore, në mënyrë të përsëritur.
- Shkeljet për mosregjistrimin e të dhënave të subjekteve që lëshojnë fatura.

Kodi Penal, në të cilën referohet dhe legjislacioni i procedurave tatimore, në pjesën e posaçme ndan veprat penale sipas objektit grupor të tyre, sipas fushës ose sferës së marrëdhënieve juridiko-penale që cenohen prej tyre duke i përfshirë në krerë dhe seksione të veçanta, si krime kundër pasurisë, në sferën juridike etj.

Duke iu referuar sferës së marrëdhënieve juridiko-penale, që preken prej këtyre veprave, janë veprimet e kundërligjshme që cenojnë ushtrimin e aktivitetit tregtar. Këto veprime mund të kryhen nga vetë shoqëria tregtare, por ndodh që subjekt të jetë edhe organi tatimor.

Neni 180 i Kodit penal – Fshehja e të ardhurave

Fshehja e të ardhurave:

“Fshehja apo shmangia nga pagimi e detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përlogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se pesë milionë lekë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se tetë milionë lekë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.”

Krijimi i shoqërive të reja me qëllim fshehjen dhe uljen e shpenzimeve.

I përdorur gjerësisht është rasti i krijimit të bizneseve të vogla me qarkullim ekonomik nën 10 (dhjetë) milionë lekë. Këto biznese duke qenë se janë të përjashtuar nga pagesa e tatimit si dhe skema e TVSH-së, përdoren si mbulesë për shtimin e shpenzimeve në biznesin kryesor

Fatura me shpenzime pa thelb ekonomik

Tatimpaguesit me qarkullim të lartë të ardhurash kanë edhe një numër të lartë shpenzimesh si administrative, kosto pune, mirëmbajtje, shërbime, e të tjera të ngjashme. Këto shpenzime bëhen me qëllimin e shtimit dhe të zgjerimit të aktivitetit, pra thënë ndryshe janë pagesa të domosdoshme për sjelljen e të ardhurave. Kundrejt këtyre shpenzimeve nuk ka asnjë pengesë ligjore për sa kohë që ato bëhen në emër dhe për qëllime të drejta të aktivitetit. Megjithatë në ligjin mbi tatimin mbi të ardhurat dhe udhëzimin në plotësim të tij përcaktohen shpenzimet që janë të njohura (të zbritshme) sipas ligjit.

Sistemi i faturave të dubluara

Është vërejtur në praktikë se evazioni fiskal ushtrohet në masë nga faturat e rreme. Kjo praktikë është vërejtur gjatë kontrolleve tatimore të cilat kanë nxjerrë në pah edhe bashkëpunimin me furnitorët jashtë kufijve.

Mosdorëzimi i dokumentave/deklaratave tatimore

Mosdorëzimi i dokumenteve tatimore përfshin tërësinë e veprimeve dhe mosveprimeve të cilat kanë qëllim të fshehin aktivitetin ekonomik të tatimpaguesit, duke bërë të mundur shmangien nga pagimi i tatimit. Në dokumente tatimore apo deklarata tatimore, përfshihen deklaratimet mbi shitjet dhe blerjet e aktivitetit, llogaritë dhe transfertat bankare, mjetet dhe aktivet në pronësi, deklaratat e tatimit në burim, deklaratat e TVSH-së, pasqyrat financiare të bilancit dhe të ardhurave e shpenzimeve.

Fshehje e të ardhurave me anë të deklarimit të rremë të inventarit të mallrave

Në praktikë janë verifikuar raste në të cilat gjendja kontabël e inventarit të shoqërive nuk përputhet me gjendjen fizike ose reale të mallrave të gjendura në magazina. Mospërputhja e gjendjes reale me atë kontabël vjen për shkak të shitjes së mallrave pa faturë apo dokument tjetër tatimor. Shitja

e mallrave pa faturë nga ana tjetër sjell ulje të gjendjes reale të mallit, jo në raport të njëjtë me gjendjen kontabël. Një pjesë e mirë e subjekteve tatimore përdorin këtë metodë si një nga mënyrat më të mira të shmangies së tatimeve.

Neni 180/a i Kodit penal, - Moslëshimi i kuponit tatimor, ushtrimi i aktivitetit pa qenë i regjistruar

Moslëshimi i kuponit tatimor

(Shtuar me ligjin nr. 135/2015, datë 5.12.2015)

Moslëshimi i kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore nga personi, i cili ka detyrimin të lëshojë kuponin tatimor, dëftesën ose faturën tatimore, kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Ushtrimi i një aktiviteti tregtar të paligjshëm ose të paregjistruar në organet tatimore, të papajisur me kasë fiskale, sipas dispozitave ligjore në fuqi, ose dhënia e urdhrave në kundërshtim me ligjin, me qëllim moslëshimin e kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore, kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 181 i Kodit penal – Mospagimi i taksave dhe tatimeve

Mospagimi i taksave dhe tatimeve

Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Pagimi i taksave dhe i tatimeve të vendosura me ligj të posaçëm nga shteti, ndikon në forcimin e sistemit fiskal të shtetit. Për këtë nen Kodi Penal parashikon se: “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësitë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Ashtu si edhe në veprën e analizuar më sipër, edhe për këtë vepër objekti është kundërligjshmëria e veprimeve gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar. Këtë vepër e karakterizon qëndrimi pasiv i subjektit (mosveprimi). Pra duke mos paguar tatimet dhe taksat brenda afatit ligjor. Duhet të plotësohen njëkohësisht tri kushte që të jemi përpara kësaj vepre penale.

Ato janë:

a) Mospagimi i tatimeve dhe taksave brenda afatit të caktuar nga organi shtetëror kompetent për llojin e tatimeve dhe taksave. Pra një element shumë i rëndësishëm për cilësimin juridik të kësaj vepre është elementi “kohë”.

b) Gjithashtu mundësia materiale e pagimit të tatimit apo të taksës nga person i detyruar është një tjetër kusht për të pasur përgjegjësi penale, pra aftësia pagueuse e tatimpaguesit. Nëse personi ka ose jo mundësinë financiare për pagimin e tatimit apo taksës, kjo është një çështje e cila zgjidhet

nga organet përkatëse, organet financiare ose nga gjykata kur çështja i ka shkuar asaj për gjykim. Në rastet kur vërtetohet se nuk ka mundësi për t'i paguar, atëherë veprohet sipas Ligjit Nr. 8901, datë 23.05.2002, Ligji “Për falimentimin”.

c) Një kusht tjetër shumë i rëndësishëm për figurën e krimit të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal është që, ndaj personit të jenë marrë më parë masa administrative për vjeljen e tatimeve dhe taksave. Vetëm pasi të ketë filluar aplikimi i masave administrative mund të fillojë hetimi penal. Nuk është e rëndësishme kur janë marrë këto masa si dhe nëse ka përfunduar ose jo shqyrtimi administrativ. Paralelisht me të mund të fillojë hetimi penal ndaj subjektit tatimpagues. Ligji për procedurat tatimore njih “parimin e ndjekjes së dyfishtë”⁸⁹. Në praktikën gjyqësore është pranuar që këto masa administrative të jenë marrë për vjeljen e një tatimi apo takse, por asnjëherë për kështet e të njëjtit tatim ose taksë.

Neni 182 i Kodit Penal – Ndryshimi në aparatet matëse

Vepra penale “Ndryshimi në aparatet matëse”.

Në bazë të këtij neni Kodi Penal parashikon: “Ndryshimi apo ndërhyrja në aparatet dhe arkat matëse, regjistruese e të lëshimit të kuponëve, apo përdorimi i aparateve dhe arkave të ndryshuara, apo lejimi i përdorimit nga të tjerët i aparateve apo arkave të parregullta, me qëllim shmangien nga pagimi i plotë i tatimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.”

Kundërligjshmëria e kësaj vepre, konsiston në ushtrimin e veprimtarive të parregullta të shoqërive tregtare lidhur me mosdeklarimin real të të ardhurave të realizuara nëpërmjet pajisjeve fiskale. Kjo veprimtari, e cila vjen në kundërshtim me ligjin, cenon drejtpërsëdrejti aparatën shtetëror. Kjo veprë prek interesa të lidhura me buxhetin e shtetit.

Sipas legjislacionit tatimor të gjithë shitësit e mallrave dhe shërbimeve, në biznese të vogla ose të mëdha, janë të detyruar që të mbajnë aparatet matëse për mallrat dhe shërbimet që ofrojnë, dhe duhet të lëshojnë faturë tatimore.

Format e kryerjes së veprës formojnë figura penale më vete.

Mënyra e realizimit të qëllimit kriminal kryet nëpërmjet formave si më poshtë:

a) Ndryshimi ose ndërhyrja në aparatet dhe në arkat matëse, regjistruese e të lëshimit të kuponëve, ose përdorimi i aparateve dhe i arkave të ndryshuara, ose lejimi i përdorimit nga të tjerët i aparateve ose arkave të parregullta, me qëllim shmangien nga pagimi i plotë i tatimit, për të fshehur burimet e të ardhurave dhe për të shmangur pagimin e tatimeve dhe taksave.

b) me përdorim të aparaturave dhe arkave të ndryshme për të mos regjistruar burimet e të ardhurave.

c) Me lejimin e aparateve dhe arkave matëse të parregullta për t'i përdorur të tjerët.

Neni 182/a i Kodit penal, Prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare

Vepra penale “Prishja e shenjave të bllokimit ose pezullimit të veprimtarisë tregtare.

Në Kodin e Ri Penal, në nenin 182 është shtuar edhe neni 182/a. Praktika e viteve të fundit tregoi nevojën e plotësimit të Kodit Penal me një normë të re në fushën e tatimeve, e cila parashikon përgjegjësinë penale në prishjen e shenjave të bllokimit ose të pezullimit të veprimtarisë tregtare.

“Prishja me dashje e shenjave dalluese, të vendosura nga administrata tatimore për bllokimin apo pezullimin e veprimtarisë tregtare, apo ushtrimi i veprimtarisë tregtare pas njoftimit të vendimit të administratës tatimore për bllokimin apo pezullimin e saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit”.

Ashtu si edhe në veprat e tjera të trajtuara më sipër edhe këtu, kundërligjshmëria qëndron në cenimin e marrëdhënieve të krijuara gjatë ushtrimit të një aktiviteti, të mbrojtura posaçërisht nga ligji penal.

Mënyrat me të cilat kryhet kjo vepër formojnë në vetvete dy figura të veprës penale të cilat shprehen me veprime të kundërligjshme në këto forma:

a) Me prishjen me dashje të shenjave dalluese të vendosura nga administrata tatimore, me qëllim pezullimin e veprimtarisë tregtare.

b) Me ushtrimin e veprimtarisë tregtare edhe pse administrata tatimore ka vendosur pezullimin apo bllokimin e saj. Nëse kryet në një nga format e mësipërme kemi vepërpenale. Parashikimet e ligjit shqiptar lidhur me këtë kundërvajtje penale janë si më poshtë:

Rasti i Shqipërisë

Përkufizimi i evazionit sipas Ligjit të Procedurave Tatimore është:

“Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë në përllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor.”

Veprat penale në fushën fiskale në Shqipëri parashikohen në Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008, të Procedurave Tatimore, nenin 131.

Veprat penale dhe dënimet e parashikuara për to, në Ligjin e Procedurave Tatimore dhe Kodin Penal, janë vendosur në tabelën si më poshtë:

Veprat penale	Dënimi minimal	Dënimi maksimal
Evazion tatimor (Kodi Penal, neni 181 dhe Ligji për Procedura Tatimore, neni 116)	- Gjobë me 100 % të diferencës së shumës së përllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt. - Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se pesë milionë lekë, dënohet me burgim dy vjet. - Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se tetë milionë lekë, dënohet me burgim katër vjet.	- Tre vjet burgim. - Pesë vjet burgim. - Tetë vjet burgim.
Nuk mbledh tatimin dhe nuk e paguan në buxhet. (Kodi Penal, neni 181)	Gjobë.	Tre vjet burgim.
Evazion lidhur me shkeljet për mosregjistrimin e të dhënave të subjekteve që lëshojnë fatura në përputhje me legjislacionin në fuqi për faturën	- Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët nuk janë të regjistruar për TVSH-në, dhe tatimpagues të tjerë dënohen me gjobë prej 25 000 lekësh; - Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të	Tre vjet burgim.

dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit. (Kodi Penal, neni 180 dhe Ligji për Proçedurat Tatimore, neni 122, paragarfi 1)	thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 50 000 lekësh; c) Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 75 000 lekësh	
Evazion lidhur me mbajtjen në ruajtje, përdorimi ose transporti i mallrave të pashoqëruara me dokumente tatimore, në mënyrë të përsëritur. (Kodi Penal, neni 180 dhe Ligji për Proçedura Tatimore, neni 121)	a)Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi, të cilët nuk janë të regjistruar për TVSH-në, dhe tatimpagues të tjerë dënohen me gjobë prej 25 000 lekësh; b)Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi dhe për TVSH-në dënohen me gjobë prej 50 000 lekësh, por jo më pak se vlera e TVSH-së së munguar; c)Tatimpaguesit e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi fitimin korporativ dënohen me gjobë prej 750 000 lekësh, por jo më pak se vlera e TVSH-së së munguar; ç) personi, i cili ushtron veprimtari ekonomike tregtare i paregjistruar, sipas përcaktimeve të nenit 41 të ligji për procedurat tatimore, dënohet me gjobë prej 50 000 lekësh	Tre vjet burgim.
Evazion tatimor lidhur me mosdeklarimin e punonjësve dhe fshehjen e pagës (Kodi Penal, neni 180 dhe Ligji për Proçedura Tatimore, neni 119)	Mosdeklarimi i punonjësve: Tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 200 000 (dyqind mijë) lekësh; tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh Fshehja e pages: 200% të detyrimit dhe kontributit të llogaritur për tatimpaguesit entitete juridike; 100% të detyrimit dhe kontributit për të gjithë tatimpaguesit e tjerë.	Tre vjet burgim.
Nuk mbledh detyrimin tatimor dhe kontributet e	Detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së	Tre vjet burgim.

sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ose nuk i paguan ato në buxhet. (Kodi Penal, neni 181 dhe Ligji për Proçedurat Tatimore, neni 114)	detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Gjoha nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.	
Fsheh ose shkatërron libra dhe regjistrime, dokumente, deklarata apo informacion tjetër të rëndësishëm për detyrimin tatimor. (Kodi Penal, neni 180 dhe Ligji për Proçedurat Tatimore, neni 118)	Gjobë me 10 000 lekë për çdo shkelje, në rastet kur është person fizik që ushtron veprimtari ekonomike tregtare apo si i vetëpunësuar dhe 50 000 lekë kur është person juridik.	Tre vjet burgim.
Dorëzon dokumente, deklarata tatimore ose informacion të falsifikuar . (Kodi Penal, neni 186)	1. Dënohet me burgim. 2. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim gjashtë muaj. 3. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim një vit.	1. Tre vjet burgim. 2. Katër vjet burgim. 3. Shtatë vjet burgim.
Mos dhënia e informacionit organeve tatimore. (Ligji për Proçedura Tatimore, neni 126)	Gjobë 10 000 lekë për çdo shkelje	Gjobë 50 000 lekë për çdo shkelje
Në bashkëpunim me një zyrtar tatimor, paguan ose pranon ryshfete; e) i ofron ryshfet një zyrtari	1. Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për	1. Një vit burgim.

tatimor. (Kodi Penal, neni 244)	të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim gjashtë muaj. 2. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50.000 lekë, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim një vit.	2. Tre vjet burgim.
---------------------------------	--	---------------------

Vepra penale të tjera sipas Kodit Penal:

Shkelja	Sanksioni minimal	Sanksioni maksimal	Parashkrimi
Neni 180 – Fshehja e të ardhurave	2 vite burgim	8 vite burgim	10 vite
Neni 180/a, - Moslëshimi i kuponit tatimor, ushtrimi i aktivitetit pa qenë i regjistruar	Gjobë	3 vite burgim	5 vite
Neni 181 – Mospagimi i taksave dhe tatimeve	Gjobë	3 vite burgim	5 vite
Neni 181/a Moskryerja e detyrave nga organet tatimore	5 vite burgim	10 vite burgim	10 vite
Neni 182 – Ndryshimi në aparatet matëse	2 vite burgim	2 vite burgim	3 vite
Neni 182/a Prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare	1 vit burgim	1 vit burgim	3 vite
Neni 170/a i K.Penal – Punësimi i paligjshëm	Gjobë 10 mijë lekë	2 vite burgim	3 vite
Neni 197 – Organizimi i llotarive të palejuara	1 vit burgim	5 vite burgim	5 vite
Neni 198- Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara	Gjobë	6 muaj burgim	3 vite
Neni 144/a Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar	3 vite burgim	10 vite burgim	10 vite

Parashkrimi: Siç u theksua më lart, periudha e parashkrimit për krimet tatimore të përcaktuara në KP ndryshon në varësi të peshës së veprës penale. (KP, neni 66 e në vijim). Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: a) dyzet vjet në rastin e krimeve që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm; b) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të

rëndë; c) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim; ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë; d) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim; dh) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë.

Bashkëfajësia: Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre. Organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit kanë përgjegjësi si edhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre. Në caktimin e dënimit për bashkëpunëtorët, gjykata duhet të mbajë parasysh shkallën e pjesëmarrjes së secilit dhe rolin e luajtur në kryerjen e veprës penale. (KP, nenet 25-28).

Tentativa: Në sistemin penal shqiptar, përkufizimi i përgjithshëm i krimit në tentativë përshkruhet në nenin 32 të Kodit Penal, sipas të cilit vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.

Shkeljet e profesionistëve: Moskryerja e detyrave që lidhen me vjeljen brenda afatit të caktuar ligjor të taksave dhe tatimeve nga punonjësit e organeve tatimore dhe personat e tjerë zyrtarë, që janë ngarkuar me këto detyra, kur bëhet për fajin e tyre, dënohet me burgim deri në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet (KP neni 181/a).

Juridiksioni territorial dhe kombësia: Territori i Republikës së Shqipërisë, në kuptim të ligjit penal, quhet hapësira tokësore, gjerësia e ujërave territoriale dhe të brendshme detare, hapësira ajrore që shtrihet mbi hapësirën tokësore dhe të ujërave territoriale dhe të brendshme detare, si dhe çdo vend tjetër ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqiptar, si selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare, anijet që mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë, anijet e marinës luftarake, të aviacionit ushtarak ose civil kudo që ndodhen.

Për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë zbatohet ligji penal i Republikës së Shqipërisë. 3 Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen krim në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj. Kushti për dënueshmërinë e njëkohshme në territorin e shtetit tjetër nuk zbatohet në rastet e krimeve të korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm. Në kuptim të këtij neni shtetas shqiptarë do të konsiderohen edhe ata persona që përveç shtetësisë shqiptare gëzojnë edhe shtetësi tjetër. (KP- nenet 5,6)

Përgjegjësia e personit juridik: Personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre. Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike. Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale. Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për

vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë

Disponueshmëria e zbritjeve tatimore për sanksionet civile dhe penale dhe pasuritë e konfiskuara: Ligji shqiptar nuk lejon zbritje tatimore për sanksionet civile dhe penale, ose pasuritë e konfiskuara.

2. Veprat penale dhe dënimet- raste të shteteve të BE¹

Rasti i Austrisë

Veprat penale	Sanksioni minimal	Sanksioni maksimal
Evazioni fiskal (FPC, neni 33)	Gjobë prej 20% të taksës së shmangur	Dyfishi i tatimit të shmangur dhe katër vjet burgim
Evazioni i pagesës së TVSH-së (FPC, neni 33.2a)	Gjobë prej 20% të taksës së shmangur	Dyfishi i tatimit të shmangur dhe katër vjet burgim.
Evazioni fiskal i kryer si anëtar i një grupi kriminal prej të paktën 3 personash (FPC, neni 38a)	Nëse shuma e shmangur nuk i kalon 100 000 euro: Gjobë prej 30% të tatimit të shmangur Nëse shuma e shmangur tejkalon 100 000 euro: pa gjobë minimale shtesë Personi juridik: Gjobë prej 30% të tatimit të shmangur	Nëse shuma e evituar nuk i kalon 100 000 euro: trefishi i shumës së shmangur dhe burgim deri në tre muaj Nëse shuma e shmangur kalon 100 000 euro: burgim deri në pesë vjet; përveç dënimit me burgim i cili nuk i kalon katër vjet, mund të vendoset një gjobë deri në 1 500 000 euro. Personat juridikë: trefishi i tatimit të shmangur
Mashtrimi tatimor duke përdorur dokumente/prova të rreme ose të falsifikuara me qëllim të përfitimit të një avantazhi të rregullt fiskal (FPC, neni 39)	Nëse shuma e shmangur nuk i kalon 500 000 euro: nuk ka gjobë minimale shtesë Nëse shuma e shmangur tejkalon 500 000 euro: një vit burgim.	Nëse shuma e shmangur nuk kalon 500 000 euro: burgim deri në pesë vjet; përveç dënimit me burgim i cili nuk i kalon katër vjet, mund të vendoset një gjobë deri në 1 500 000 euro. Personat juridikë: gjobë deri në 5 000 000 euro Nëse shuma e shmangur tejkalon 500 000 euro: deri në dhjetë vjet burgim, përveç dënimit me burgim që nuk kalon tetë vjet, mund të gjobitet deri në 2 500 000 euro. Personat juridikë: gjobë deri në 8 000 000 euro
Mashtrimi tatimor i kryer duke përdorur prova të rreme ose të falsifikuara, sisteme të manipuluar të kontabilitetit	Nëse shuma e shmangur nuk i kalon 500 000 euro: nuk ka gjobë minimale shtesë Nëse shuma e shmangur tejkalon 500 000 euro: një vit burgim.	Nëse shuma e shmangur nuk kalon 500 000 euro: burgim deri në pesë vjet; përveç dënimit me burgim i cili nuk i kalon katër vjet, mund të

¹ <https://www.oecd.org/corruption/crime/fighting-tax-crime-the-ten-global-principles-second-edition-country-chapters.pdf>

ose marrëveshje ose sjellje të rreme (FPC, neni 39)		vendoset një gjobë deri në 1 500 000 euro. Personat juridikë: gjobë deri në 5 000 000 euro Nëse shuma e shmangur tejkalon 500 000 euro: deri në dhjetë vjet burgim, përveç dënimit me burgim që nuk kalon tetë vjet, mund të gjobitet deri në 2 500 000 euro. Personat juridikë: gjobë deri në 8 000 000 euro
---	--	---

Parashkrimi: Të gjitha veprat e mësipërme kanë një parashkrim prej pesë vjetësh. Afati i parashkrimit fillon në ditën kur rezulton efektivisht rezultati i përshkruar në përkufizimin ligjor të krimit. Pezullimi i afatit të parashkrimit ndodh pas fillimit të një hetimi penal. Austria vëren se, në përvojë, kjo paraqet vështirësi në rastet kur një raport për krimet tatimore merret pak para ose pas skadimit të periudhës së kufizimit (p.sh. në çështjen Panama Papers).

Bashkëfajësia: Është gjithashtu një vepër penale, e dënueshme me të njëjtat dënime maksimale si vepra kryesore, të ndihmsh dhe bashkëpunosh me një person tjetër për të kryer ndonjë nga këto vepra (FPC, neni 11).

Tentativa dhe komploti: Komploti dhe përpjekja për të kryer një dënim tatimor është një vepër penale në Austri (FPC, neni 13 dhe neni 11).

Shkeljet e profesionistëve: Austria nuk ka një regjim të posaçëm ndëshkimi për profesionistët e fushës, të cilët ndihmojnë në kryerjen e veprës penale duke dhënë mendime, raporte, duke vertëtuar dhe certifikuar pasqyrat e bilanceve. Përkundrazi, këta janë përgjegjës në të njëjtën mënyrë si shkelësit dytësorë.

